REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.6749/1 Prot. Maliq, më 21.11.2025

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e mërkurë, **më datë 26.11.2025, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.09.2025.
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin tetor 2025";
5. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.P.B banues në fshatin Sovjan NJ.A Pirg, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
6.P-V "Për miratimin e sistemeve të pikëzimit, për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë";
7.P-V "Për mbylljen e Agjencisë së Shërbimeve Mbështetës Maliq dhe kalimin pranë stukturës së Bashkisë Maliq";
8.P-V "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Maliq nr.75 datë 30.06.2025, *"Për ngritjen e bordit artistik të Bashkisë Maliq";*
9.P-V "Për miratimin e dokumentit të Politikave, Planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Maliq për periudhën janar-dhjetor 2026";
10.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e Martë me datë 25.11.2025 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut. Pikat 4 e rendit të ditës:
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat: 7, 9 e rendit të ditës:
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit. Pika 5 e rendit të ditës: z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, z.Yllson Ibrahimllari.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 6 e rendit të ditës: z.Idlir Limllari, z.Eriseld Jonusllari, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholli,

Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve. Pika 8 e rendit të ditës.znj.Floreta Zaçe, znj.Daniela Ibarahim, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi, z.Server Xhuti.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI